



Heritage Foundation – Indeksi i Tregtisë së Lirë, Shqipëria renditet e 13-ta në botë



Indeksi i Tregtisë së Lirë për vitin 2017 i “Heritage Foundation” e rendit Shqipërinë në vendin e 13-të në botë dhe të parin në rajon ndër 186 vende të botës. Ministrja e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, znj. Milva Ekonomi, e konsideroi këtë si një lajm tjetër pozitiv për Shqipërinë, duke theksuar se ky indeks është ndër më prestigjiozët në nivel ndërkombëtar dhe, sipas këtij klasifikimi, Shqipëria arrin në vend të parë në rajon. Në një konferencë të posaçme për mediat mbi këtë publikim, Ministrja informoi se raporti në fjalë publikohet çdo vit nga “Heritage Foundation” dhe këtë vit vendi ynë rezulton të jetë i përmirësuar me 20 pozicione në renditje. Ky është një tregues domethënës për vendet që aplikojnë barriera të ulta tregtare, që ndikon në zgjerimin e shkëmbimeve tregtare dhe rritjen ekonomike. Qasja kryesore e këtij indeksi bazohet në peshën që zënë tarifët doganore si dhe barrierat jo tarifore. Shqipëria vlerësohet me një rezultat mbresëlënës, sepse ka çfarë të tregojë. Sipas sistemit të harmonizuar të nomenklaturës së mallrave për Shqipërinë: 49% e kësaj liste është me tarifë doganore 0%; 18% e kësaj liste është me tarifë doganore 2%; 0.3% e kësaj liste është me tarifë doganore 5%; 2,4% e kësaj liste është me tarifë doganore 6% ; 19,3% e kësaj liste është me tarifë doganore 10%; 12% e kësaj liste është me tarifë doganore 15%; “Këto vlerësime pozitive nga raportet ndërkombëtare gjatë këtij viti na forcojnë bindjen se reformat e marra janë në drejtimin e duhur. Ndaj nuk ishte rastësi vlerësimi i Raportit të BB “Doing Business 2017”, ku Shqipëria u rendit në vendin e 58-t/190 vende, duke u përmirësuar me 32 pozicione. Qeveria dhe Ministria që unë drejtoj jemi të vendosur të vazhdojmë reformat e duhura për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm dhe një treg gjithnjë e më shumë konkurrent”, u shpreh Ministrja Ekonomi.

<http://www.ekonomia.gov.al/al/newsroom/lajme/heritage-foundation-indeksi-i-tregtise-se-lire>

Projektbuxheti 2017, implementim i reformave dhe konsolidim i zhvillimit ekonomik



Projektbuxheti i shtetit dhe paketa fiskale për vitin 2017 u miratuan në parim nga Parlamenti, në seancën plenare të datës 1 Dhjetor. Projektbuxheti u miratua me 82 vota pro dhe dy kundër. Ministrja e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, znoj. Milva Ekonomi, tha se buxheti i vitit të ardhshëm siguron vazhdimin e reformave të ndërmarra nga qeveria, duke theksuar se në total ai është rreth 20 miliardë lekë, ndërsa për ministrinë që ajo drejton do të jetë 2 miliardë e 51 milion lekë (2.051 mln lekë). Sipas Ministres, projektbuxheti 2017 është 23.3 për qind më i lartë se në vitin 2014 dhe investimet e parashikuara 52.7 për qind më të larta, krahasuar po me vitin 2014. Ministrja theksoi më tej se planifikimet buxhetore të viteve të fundit kanë bërë të mundur realizimin e reformave dhe konsolidimin e rritjes ekonomike të vendit, shoqëruar me investime të qëndrueshme brenda hapësirave fiskale. Po ashtu, Ministrja Ekonomi nënvizoi edhe faktin se projektbuxheti i vitit 2017 rrit pagat dhe pensionet. “Qeveria e mëparshme ndau për rroga e pensione në buxhetin e shtetit në 8 vjet, 124 milionë dollarë, ndërsa kjo qeveri falë uljes së taksës mbi rrogën dhe buxhetit të dedikuar për rritje pagash dhe pensionesh u jep mundësi plot 700 mijë pensionistëve dhe punonjësve të administratës të përfitojnë 240 milionë dollarë brenda një mandati të vetëm. Kjo rritje e konsiderueshme e pagave dhe pensioneve realizohet në kushtet e një buxheti me sufiçit primar, pra financohet tërësisht nga të ardhurat buxhetore dhe jo nga para të marra hua”, tha Ministrja. Duke u ndalur edhe një herë te buxheti i MZHETTS, Ministrja tha se ai do të vazhdojë të mbështesë sipërmarrjen, tregtinë dhe turizmin, me qëllim zhvillimin ekonomik të vendit. “Ky është buxheti i konsolidimit të zhvillimit ekonomik dhe vazhdimin të implementimit të plotë të reformave të ndërmarra. Gjatë këtyre viteve siguroam rritjen e qëndrueshme ekonomike dhe e konsoliduam atë, nga më pak se 1% në 2013, në 2% në 2014, në 2.62% në 2015 dhe në 3,4 % për vitin 2016. Ndërsa për vitin 2017, FMN parashikon një rritje me 3,8% të ekonomisë së vendit tonë, duke e renditur atë si ekonominë me dinamike në Ballkan”, u shpreh Ministrja Ekonomi gjatë fjalës së saj. Sipas Ministres së MZHETTS, buxheti 2017 siguron nivel optimal të investimeve publike me rreth 5% e PBB, duke arritur nivelin më të ulët të deficitit të programuar ndonjëherë, prej rreth 2% të PBB. Investimet publike, theksoi znoj. Ekonomi, do të vijojnë mbështetjen e sektorëve kyç të ekonomisë, me qëllim përmirësimin e shërbimeve publike dhe jetës së qytetarëve. Më poshtë fjala e Ministres Ekonomi mbajtur dje në Parlament për Buxhetin 2017:

<http://www.ekonomia.gov.al/al/newsroom/fjalime/fjala-e-ministres-se-zhvillimit-ekonomik-turizmit-tregtise-dhe-sipermarrjes-znoj-milva-ekonomi-ne-parlament-per-buxhetin-2017&page=1>

Takim në MZHETTS me përfaqësues të Kompanive Call Cente



Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë e Sipërmarrjes zhvilloi një takim lidhur me shqetësimin e shfaqura së fundi nga kompanitë 'Call Center' që operojnë në vendin tonë, pas propozimit në Itali të ligjit 83/2012 që rirregullon këtë sektor shërbimesh. Të pranishëm në takim ishin znj Milva Ekonomi, Ministre e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes; z. Blendi Klosi Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë; përfaqësues të Ambasadës Italiane; të shoqatës Call Center, drejtues ekzekutivë të këtyre kompanive; përfaqësues të Unionit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë, etj. Në këtë takim u dëgjuan argumentet e grupeve të interesit, të cilët ngrënë shqetësimin se ligji në fjalë mund të sjellë një impakt të madh jo vetëm në uljen e fitimeve të tyre, shkurtimin e vendeve të punës, por dhe më tej, në mbylljen e mjaft kompanive të këtij lloji dhe zhvendosjen e tyre në shtete brenda Bashkimit Europian, si Rumani apo Kroaci. Ministrja Ekonomi theksoi se qeveria Shqiptare i ka ndjekur me mjaft interes këto shqetësime të operatorëve Call Center që kanë aktivitetet e tyre në Shqipëri, duke i garantuar se është në anën e tyre, pasi janë mbi 804 kompani që kanë punësuar rreth 25 046 punonjës, kryesisht të rinj. Ajo ftoi pjesëmarrësit që të japin gjithë argumentet e tyre dhe këto të unifikohen në një dokument, i cili më pas do t'i dërgohet ambasadës italiane në Tiranë për t'ia përcjelle zyrtarisht këto shqetësime qeverisë italiane lidhur me amendimin e ligjit në fjalë që është miratuar në dhomën e Deputeteve dhe pritet të kalojë së afërmi në Senat.

<http://www.ekonomia.gov.al/al/newsroom/lajme/takim-ne-mzhetts-me-perfaqesues-te-kompanive-call-center>

Ministrja Ekonomi fton bizneset gjermane për investime në Shqipëri



Ministrja e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, znj. Milva Ekonomi mori pjesë në forumin e përbashkët ekonomik Shqipëri-Gjermani të zhvilluar në Berlin, më 28 nëntor, në ditën e Festës Kombëtare të Shqiptarëve. Në këtë forum, Ministrja Ekonomi, prezantoi arritjet e njohura ndërkombëtarisht të Shqipërisë në disa prej organizatave ndërkombëtare si Banka Botërore me 'Doing Business', OECD me Indeksën e Konkurrueshmërisë, Social Progress index, parashikimet e FMN dhe BB për situatën ekonomike 2017. Ajo u ndal tek arritjet e qeverisë dhe treguesit e përmirësuar buxhetorë, duke theksuar se buxheti i këtij viti, jo vetëm që merr përsipër të vazhdojë reformat e nisura dhe të mbështesë rritjen ekonomike, por akomodon edhe reformat në drejtësi, në administratën publike, atë territoriale etj. Ky buxhet sjell 7,6 % më shumë të ardhura se 2016, falë rritjes ekonomike dhe përpjekjeve të qeverisë në luftën kundër informalitetit, regjistrimin e bizneseve etj., të cilat do të japin mundësi të rriten pagat dhe pensionet dhe të investohet në vepra publike 5% e PBB. Znj. Ekonomi i njohu të pranishmit me situatën ekonomike të Shqipërisë, duke vënë theksin veçanërisht te potencialet e mëdha që ka Shqipëria për investime të huaja. Në prezantimin e saj, Ministrja Ekonomi ftoi bizneset gjermane të investojnë në disa sektorë kyç, si sektori i energjisë, transporteve, turizmi, etj. Këta sektorë, edhe në kuadër të bashkëpunimit rajonal, kanë nevojë të zhvillohen për të mundësuar një rajon që kërkon të integrohet dhe të fuqizojë ekonominë e secilit shtet ballkanik. Vendet e Ballkanit Perëndimor e kanë kuptuar tashmë këtë ndaj po punojnë për të lehtësuar ndërlidhjen dhe minimizuar barrierat jotarifore. Znj. Ekonomi theksoi dhe mundësinë që ka krijuar qeveria shqiptare për ata që duan të investojnë në Shqipëri duke vënë në dispozicion hapësira me qera simbolike 1 euro, ose duke krijuar lehtësira fiskale më të shumta brenda një zone ekonomike e teknologjike zhvillimi. Ajo shtoi se ende ka shumë për të bërë dhe mjaft reforma të tjera janë në proces, por më e rëndësishme mbetet reforma në Drejtësi. I pranishëm në këtë forum ishte dhe raporterit për Shqipërinë në parlamentin Europian, Knut Fleckenstein. Ai u ndal kryesisht te reforma në drejtësi dhe rëndësia e madhe e ka kjo reformë jo vetëm për anëtarësimin e Shqipërisë në BE por dhe për gjithë shoqërinë shqiptare dhe për zhvillimin e biznesit.

<http://www.ekonomia.gov.al/al/newsroom/lajme/ministrja-ekonomi-fton-bizneset-gjermane-per-investime-ne-shqiperi&page=1>

Ministrja Ekonomi në Prishtinë: Nuk ka asnjë barrierë në shkëmbimet tregtare Shqipëri-Kosovë



Nuk ka asnjë barrierë në shkëmbimet tregtare Shqipëri-Kosovë. Çështjet e kaluara në këtë drejtim janë zgjidhur falë rritjes së bashkëpunimit dhe nënshkrimit të një sërë marrëveshesh ekonomike mes dy vendeve. Ky ishte konkluzioni i takimit të zhvilluar në Prishtinë mes Ministres së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, znj. Milva Ekonomi dhe Ministres së Tregtisë dhe Industrisë të Republikës së Kosovës, Znj. Hykmete Bajrami. Në takimin e përbashkët, dy Ministret uruan për festën e përbashkët të shqiptarëve, 28 nëntorin, Ditën e Flamurit.

Ato shprehën kënaqësinë për bashkëpunimin e shkëlqyer mes dy vendeve, duke shtuar se ende ka shumë hapësira për ta zgjeruar më tej këtë bashkëpunim. Ato premtuan se institucionet respektive do të bëjnë të pamundurën që kompanitë e Shqipërisë dhe Kosovës të mos kenë asnjë pengesë në shkëmbimet tregtare. Në një konferencë të përbashkët për mediat pas takimit, Ministrja Bajrami konstatoi se janë 900 kompani me kapital nga Shqipëria që ushtrojnë aktivitetin në Kosovë që nga 2007, ndërkohë që 14 prej tyre kanë punësuar 1400 punëtorë në Kosovë. Ajo theksoi se marrëveshjet e fundit mes dy vendeve kanë lehtësuar tregtinë mes dy vendeve. Ndërsa Ministrja Ekonomi, duke ndarë të njëjtin mendim për bashkëpunimin shumë të mirë ekonomik mes dy vendeve, u shpreh se duhet bërë më shumë për të krijuar mundësi që produktet tona të jenë të kokurrueshme në tregun ballkanik dhe atë europian dhe për këtë duhen ndërmarrë veprime konkrete në të ardhmen.

<http://www.ekonomia.gov.al/al/newsroom/lajme/ministrja-ekonomi-ne-prishtine-nuk-ka-asnje-barriere-ne-shkembimet-tregtare-shqiperi-kosove&page=1>

Ministrja Ekonomi viziton panairin “Bli Shqip” në Prishtinë



Ministrja e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes vizitoi Prishtinën në kuadër të Panairit të përbashkët “Bli Shqip”, i cili organizohet çdo vit nga Komuna e Prishtinës dhe MZHETTS, në kuadrin e festave kombëtare mbarë shqiptare. Ky panair ka si synim të promovojë produktet shqiptare e të rrisë shkëmbimet tregtare mes dy vendeve. Ministrja vizitoi nga afër standat e vendosura në panair, duke u njohur me kompanitë pjesëmarrëse dhe produktet Made in Albania që ato ekspozojnë. Ministrja Ekonomi u shpreh se ka një interesim gjithnjë e në rritje për pjesëmarrje nga bizneset shqiptare, çka do të thotë një rritje e interesit për shkëmbimin e produkteve shqiptare. “Kjo është një ngjarje e madhe për sipërmarrjen shqiptare dhe atë kosovare për njohjen e produkteve shqiptare në tërësi. Produktet tona kanë nevojë të regjistrohen si marka dhe po punojmë shumë për këtë gjë, por dhe konsumatori ka nevojë të mbrohet, ndaj dy palët po punojnë në çështjen e sigurisë ushqimore. Nuk ka pengesë që e ndal këtë bashkëpunim. Të gjithë vijnë me kënaqësi në panairin “Bli Shqip”,- u shpreh Ekonomi.

<http://www.ekonomia.gov.al/al/newsroom/lajme/ministrja-ekonomi-ne-prishtine-nuk-ka-asnje-barriere-ne-shkembimet-tregtare-shqiperi-kosove&page=1>



Agjencia Kombëtare e Turizmit është bërë pjesë e panairit Ndërkombëtar të Tiranës, i cili është zhvilluar në ambientet e Pallatit të Kongreseve. AKT ka prezantuar pranë këtij panairi Qendrën e re Multimediale, e cila ka tërhequr një numër rekord vizitorësh të huaj dhe vendas. Në kuadër të promovimit turistik shqiptar, AKT ka sjellë për herë të parë për publikun e gjerë videot, spotet dhe dokumentarët e fundit të realizuara prej saj nëpërmjet një teknologjie të re dhe shumë inovative. Këto spote promovuese, pas publikimit të suksesshëm në disa nga kanalet ndërkombëtare shumë të njohura televizive si, Euro News, Travel Channel, si dhe në Festivalin e Filmit në Venecia, do të vijojnë të jenë pjesë e fushatës promovionale të AKT-së, duke përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë diasporën shqiptare dhe përfaqësitë tona diplomatike jashtë vendit. Ndërkohë, në ditën e Pavarësisë, Agjencia Kombëtare e Turizmit prezantoi faqen e ristrukturuar web albania.al, sipas një dizajni të ri dhe shumë inovativ. Ekрани led i vendosur posaçërisht pranë stendës së AKT në panairin Ndërkombëtar të Tiranës, nën kujdesin e stafit të AKT-së, qëndroi përgjatë gjithë 28 Nëntorit në dispozicion të vizitorëve të shumtë, të cilët patën mundësi të prekin nga afër dhe të përdorin aplikacionet e shumta dhe inovative që kjo faqe web paraqet.

Akreditimi, i rëndësishëm për mbështetjen e rritjes ekonomike



Arritje të rëndësishme u evidentuan në Asamblenë e Përgjithshme të EA (Organizmi Evropian për Akreditim), zhvilluar në datat 23 - 24 Nëntor 2016 në Borås, Suedi, ku akreditimi u vlerësua si një nevojë në rritje në të ardhmen. Organizmi Akreditimit të Suedisë (SWEDAC) organizoi këtë aktivitet, ku morën pjesë përfaqësues nga 36 vende anëtare me të drejta të plota, anëtarë shok, dhe palët e tjera të interesuara. Takimi, i cili u fokusua në cilësinë dhe akreditimin, filloi me një fjalim përshëndetës nga z.Peter Strömbäck, Drejtori i Përgjithshëm SWEDAC, me një vështrim prapa në takimin e fundit të EA-së, në Maj të vitit 2016. Që atëherë, ka pasur një numër ndryshimesh në Botë - Brexit UK dhe zgjedhjet presidenciale amerikane, duke çuar në një të ardhme të pasigurt. “Nevoja për ne dhe biznesin tonë do të rritet, nevoja për besim dhe rehati në jetën e përditshme. Ne jemi një pjesë e rëndësishme e ndërtimit të një të ardhme të ndritur”, tha Peter Strömbäck. Në këtë mbledhje u miratuan dhe disa rezoluta, si më poshtë: Organizmi kombëtar i Armenisë u pranua anëtar shok në EA; Rishikimi i udhëzuesit EA-6/04: Udhëzime EA për akreditimin e Certifikimit të Produkteve sektorit primar me anë të marrjes së mostrave në vend; Adoptimi i Strategjisë e EA –së 2025, i prezantuar në Asamblenë e Përgjithshme në Maj 2016, u adoptua.

Tre objektiva strategjikë, që përcaktojnë planin dhe vizionin për të ardhmen, janë :Qeverisja e mirë për të dhënë rezultate të qëndrueshme; Bashkëpunimi i ngushtë me rregullatorët dhe palët e interesuara për të forcuar akreditimin në nivel evropian dhe ndërkombëtar; Vazhdimi i zhvillimit akreditimit, për të mbështetur inovacionin dhe rritjen ekonomike në zonat ekzistuese dhe të reja; Plani final “Zbatimi i Strategjisë”, do të paraqitet në mbledhjen e ardhshme së Asamblesë së Përgjithshme, në Maj 2017.

“Corriere della Sera”- Koha për të vizituar Tiranën



Gazeta prestigjioze italiane “Corriere della Sera”, në një shkrim special dedikuar Shqipërisë, në kuadër të 104 vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, e cilëson kryeqytetin Shqiptar si një qytet ndryshe, tërheqës, plot surpriza dhe ku vitet e fundit ka pësuar një ndryshim prej 360 °. Me një titull tërheqës për lexuesit, sipas kësaj gazete ka ardhur koha e “Shqipërisë...Tiranës, që jeton mes artit dhe lokaleve të orëve të vona”, për t’u vizituar nga turistët. Në shkrim theksohet se Tirana të ofron një “ajër” krejt ndryshe, ka moshë mesatare të re, është vend me art, ngjyra e jetë. Gjatë shkrimit përmendet edhe Kryeministri Rama dhe puna e tij si kryetar bashkie në vitet 2000, i cili cilësohet si një artist që solli ndryshimin në rolin e politikanit. “Një guidë e thjeshtë në qytetin e Tiranës. Nga muzetë e rinj tek lokalet e natës, nga hotelet më mikpritëse tek restorantet, ja çfarë nuk duhet të humbisni nga kryeqyteti Shqiptar, që sot feston 104 vjetorin e Pavarësisë së vendit. Në mënyrë të brishtë, ka filluar të kthehet në një destinacion turistik më të preferuar dhe vlerësuar për momentin, kryeqyteti i ngjyrosur i Shqipërisë është një pjesë për të mos u humbur për këdo që ka dëshirë të zbulojë një vend të afërt por ende të panjohur. Tirana është një nga kryeqytetet më të gjallë në Europë, të rinj, dhe plot gjëra për të parë si: bunkerët të transformuar në muze, galeri artesh bashkëkohor, lokale moderne, restorante cilësorë, me çmime të arsyeshme. Nëse keni dëshirë për të zbuluar një qytet ndryshe nga destinacionet e zakonshme, për më pak se një orë fluturimi nga Italia, Tirana është vendi i duhur për ju”. Artikullin e plotë mund ta gjeni në linkun e mëposhtëm :

http://viaggi.corriere.it/viaggi/vacanze/albania-e-lora-di-tirana-tra-arte-e-nightlife/?refresh_ce-cp



Adresa: Blvd. “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, Albania
Tel. / Fax: +355 42 22 34 55 / +355 42 22 34 55
E-mail: zmp@ekonomia.gov.al
Web: www.ekonomia.gov.al

